



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:085817

Datë: 13.05.2024

Numri i dokumentit: 05676660

C.nr.1086/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Agron Karatash, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestuese të inicuar me padi nga ana e paditëses A.K. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. B.K. nga Prizreni, kundër të paditurës (AAPARr) në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë, vlera e kontestit 316.00 (treqind e gjashtëmbëdhjetë) euro, me datë 13 .05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.K. nga Prizreni dhe **DETYROHET** e paditura Masht- AAPARr, që paditëses në emër të shujtave ditore për **158 ditë** pune për vitin 2022 deri me datën 21.11.2022, t'ia kompensoj shumën e përgjithshme prej **316.00 (treqind e gjashtëmbëdhjetë) euro**, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë me datë 07.04.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej **124.00 (njëqind e njëzetë e pesë) euro**, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja A.K. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj av. B.K. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 07.04.2023, ka parashtruar padi, kundër të paditurës (AAPARr) në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë, me vlerë të kontestit 316.00 (treqind e gjashtëmbëdhjetë) euro.

Në referatin e padisë autorizuari i paditëses ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune në Institucionin Arsimor SH.M.P. “Qendra e Kompetencës” në Prizren, ku e njëjta ka punuar dhe vazhdon të punojë në këtë institucion, respektivisht e njëjta për vitin 2022 deri me datën 21.11.2022 ka gjithsej 158 ditë pune në këtë institucion arsimor, duke marrë për bazë

nenin 35 para. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Më tej ka theksuar se edhe për kundër faktit se e njëjta kontratë e obligon punëdhënësin që të paguaj /kompensoj punëmarrësin dhe atë nga 2 (dy) euro për një ditë pune, punëdhënësi në këtë rast e paditura nuk e ka paguar punëmarrësin për asnjë ditë të vetme për vitin 2022, ku për kundër se paditësja i është drejtuar të paditurës për realizimin e kërkesës së saj nuk i është përgjigjur pozitivisht, andaj ka kërkuar që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditëses. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe të njëjtat i ka specifikuar dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 104 euro si dhe për taksën gjyqësore shumë prej 21 euro.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses. Ka theksuar se paditësja nuk është kompensuar në mungesë të mjeteve financiare pasi që Agjencia e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur në buxhetin e vitit 2022 nuk ka pasur buxhet për kompensimin e kësaj pagese, bazuar në nenin 46 të Kontratës Kolektive Nr.01B/2056 të datës 18.04.2017, e paditura i është drejtuar organeve kompetente siç janë Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit që t'ia mundësoj lejimin dhe buxhetimin për këtë kategori ekonomike, mirëpo deri më tani kjo nuk ka ndodhur. Bazuar në nenin 90 par.4 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar më kohëzgjatje jo më shumë se tre (3) vjet”, andaj konsiderojnë se gjykata duhet marrë parasysh këtë dispozitë ligjore të Ligjit të Punës të cituar më lartë. Më tej ka theksuar se bazuar në nenin 47 të Kontratës së re Kolektive të Arsimit në Kosovë Nr.01B/105, të datës 22.01.2021, Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.01B/2056, e datës 18.04.2017 është shfuqizuar dhe nuk është më në fuqi, po ashtu bazuar në nenin 341 i Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve me të cilën theksohet se “Me parashkrim shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit. Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen”. Në fund ka theksuar se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 deri më 17.04.2020 dhe nuk ka veprim prapa veprues, kurse paditësi ka paraqitur padi me datë 03.04.2023, pas afatit të parapar ligjor, andaj i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditëses. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënëse në SH.M.L.P “Qendra e Kompetencës” në Prizren, e cila bie në kompetencë të paditurës.

Gjykata përmes vërtetimit me numër të protokollit 5/46-2023, të datës 14.03.2023, të lëshuar nga ana e të paditurës, ka vërtetuar faktin se paditësja A.K. për vitin 2022 deri me datë 21.11.2022 ka qenë prezente në punë 158 ditë pune.

Nga leximi i kërkesës e dërguar me post me datën 17.03.2023, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja i është drejtuar A.A.A.P.A.R. për pagesën shujtave për vitin 2022, dhe e njëjta nuk i është përgjigjur kërkesës së paditëses.

Vërtetimin e lartcekur, Gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”. Andaj meqë ky dokument është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat edhe si e tillë është e pranueshme edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimin e lëshuar nga ana e SH.M.L.P “Qendra e Kompetencës”, në Prizren, si provë me të cilën vërtetohet fakti lidhur me ditët e prezencës në punë të paditëses, gjykata ia fali besimin e plotë, e nga e cila vërtetoi faktin se për 158 ditë, për vitin 2022 deri me datën 21.11.2022, paditësja ka qenë në vendin punës.

Me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021, e më saktësisht në dispozitën 35 paragrafi 7, të KKAK-së është paraparë se “*Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim*”.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditëses t’ia paguaj kompensimin për ushqimin gjatë punës, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës. Rrjedhimisht ditët e punës për paditësen, të vërtetuara nga vet punëdhënësi, për 158 ditë prezent në punë, gjykata i ka shumëzuar me shumën prej 2 euro të parapara si në nenin 35 paragrafi 7 të KKAK-së, duke ia njohur shumën e gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së, ku parashihet që “*po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij*”.

Andaj, bazuar në dispozitat e nenit 152 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditëses është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara kjo për faktin se kërkesa e paditëses ka qenë për kompensimin e shujtave për vitin 2022 e deri me datën 21.11.2022, pra në kohën kur ka qenë ende në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, ngase e njëjta ka qenë në zbatueshmëri nga data 22.01.2021 deri më 21.11.2022. Kurse sa i përket parashkrimit të kërkesës me nenin 342 të LMD-së, parashihet që *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Në rrjedhën e kësaj çështje paditësja ka kërkuar kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë për vitin 2022 deri me datën 21.11.2022. E drejta për të kërkuar kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë paditëses i ka filluar të i rrjedh nga viti 2022, ndërsa sipas nenit 87 të Ligjit të Punës shprehimisht theksohet që *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që nga i gjithë ky elaborim shihet qartë se paditësja padinë e ka parashtruar me datë 07.04.2023, brenda afatit ligjor prej tre (3) vitesh dhe se pretendimi për parashkrim nga ana e palës së paditur nuk mund të gjejë mbështetje në dispozitat ligjore të së drejtës materiale.

Po ashtu Gjykata, pretendimet e të paditurës se nuk ka mjete buxhetore të ndara për kompensimin e paditëses i gjen si të pa bazuara. Obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Marrëveshje Kolektive, i takojnë pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshje Kolektive, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditëses, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë me datë 07.04.2023, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së lidhur me Rregulloren për Tarifat e Avokatëve e datës 18 mars 2017, lartësia e shpenzimeve i referohet 104.00 euro për përpilimin e padisë, si dhe për taksën gjyqësore shumën prej 21.00 euro, gjithsej shumën prej 125.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:085817, 13.05.2024

B.profesional
Ali Kosova

Gjyqtari
Agron Karatash

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimin të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.